



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SKENDERAJT MUNICIPALITY OF SKENDERAJT
SKENDERAJT

Nr.
No. 07-112/01-0055-944/24
Data.
Data. 18. 12. 2024



Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

PLANI I PUNËS

PËR VITIN 2025

Dhjetor 2024, Skenderaj

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrje.....	3
Vizioni dhe Misioni i DKA-së.....	4
Objektivat strategjike.....	4
Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi profesional i mësimeve të mesimit.....	4
Objektivi Strategjik 2: Zbatimi i kurrikulës së re.....	5
Objektivi Strategjik 3: TIK-u dhe mjetet e konkretizimit.....	5
Objektivi Strategjik 4: Sigurimi i cilësisë.....	5
Objektivi Strategjik 5: Infrastruktura fizike.....	6
Objektivi Strategjik 6: Arsimi dhe aftësimi profesional.....	6
Objektivi Strategjik 7: Ofrimi i shërbimeve të orientimit në karrierë.....	6
Objektivi Strategjik 8: Mbështetje financiare për nxënës dhe studentë.....	6
Orientimi i përgjithshëm.....	6
Rezultatet e pritshme.....	7
Monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm.....	8
Të dhënat e përgjithshme.....	10
Numri i nxënësve sipas niveleve shkollore.....	10
Pasqyra e numrit të paraleleve sipas klasave.....	11
Pasqyra e numrit të nxënësve sipas institucioneve edukativo-arsimore publike.....	12
Numri i nxënësve sipas strukturës etnike në vitin shkollor 2024/25.....	12
Aktivitetet e DKA-së në Skenderaj për vitin 2025.....	13
Aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore.....	17
Aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin edukativo - arsimor.....	18
Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-së me kryetarin e komunës, MASHTI-n,.....	18
Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat dhe komunitetin.....	18
Bashkëpunimi me përfaqësuesin e komunës për IE.....	20
Plani i Rekrutimit të Personelit Arsimor.....	20
Buxheti i Arsimit për vitin 2025 sipas kategorive.....	21
Programi i Investimeve Kapitale për vitin 2025.....	22

Hyrje

Në këtë plan janë të përfshira të gjitha aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Arsimit, për katër nivelet shkollore sipas SNKA¹-së, dhe atë si vijon:

- SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII),
- SNKA 2 - Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasat VI-IX),
- SNKA 1 - Arsimi Fillor (Klasat I-V),
- SNKA 0 - Klasat Parafillore/Përgatitore (5-6 vjeç) dhe Arsimi Parashkollor (lindje-5 vjeç).

Ky plan i ka për bazë aktivitetet që do të realizohen në të gjitha Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta (Gjimnaze dhe Shkolla Profesionale) në komunën e Skenderaj.

Pra, plani përfshinë aktivitetet për përgatitjen e vitit të ri shkollor, aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore, bashkëpunimin e DKA-së me kryetarin e komunës, MASHTI, drejtoritë e tjera komunale, me qytetarët, komunitetin prindëror si dhe bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat, komunitetin, etj.

Plani ka për bazë edhe elementet, të cilat kanë të bëjnë me përcjelljen e trendeve të reja zhvillimore në arsim, pasurimin, furnizimin dhe shfrytëzimin permanent të teknologjisë arsimore nëpër shkolla.

¹ SNKA-Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit

Vizioni dhe Misioni i DKA-së

Vizioni: Sistem bashkëkohor i shkollimit që ofron gjithëpërfshirje, mësimdhënie cilësore dhe mundësi të zhvillimit të potencialit për secilin nxënës në funksion të të nxënës gjatë gjithë jetës, punësimit të rinjve, demokratizimit të shoqërisë dhe zhvillimit ekonomik në nivel komune. Gjithëpërfshirja, mësimdhënia cilësore, mundësitë e zhvillimit të potencialeve për secilin nxënës, punësimi i të rinjve, janë fjalët kyçe të vizionit për arsim në komunën e Skenderajt, të cilat përbëjnë bazën e orientimit për misionin e komunës së Skenderajt.

Misioni: Ofrimi i arsimit cilësor për të gjithë nxënësit e Komunës së Skenderajt, përmes mësimdhënies cilësore bashkëkohore që mbështetet me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve, përdorimin e teknologjisë moderne arsimore dhe mjeteve mësimore, krijimin e kushteve optimale dhe ambientin miqësor dhe të sigurt në shkolla, ndërlidhjen e arsimit dhe aftësimi profesional me tregun e punës, si dhe përmes fuqizimit të autonomisë së shkollës dhe mekanizmave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Objektivat strategjike

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve - Një nga prioritetet e komunës së Skenderajt është përfshirja e të gjithë mësimdhënësve në trajnime cilësore, të cilat i ndihmojnë mësimdhënësit që të jenë më kreativë në mësimdhënie dhe në ofrimin e përkrahjes së nevojshme për nxënës në zotërimin e kompetencave kryesore. Fokusi do të jetë në përcaktimin e qartë të rolit të DKA-së në ZhPM, në zhvillimin e mekanizmave për identifikim të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim të vazhdueshëm profesional, financim të ZhPM, monitorim të ZhPM si dhe në përkrahjen e shkollave për ZhPM me bazë në shkollë. Objektivi dhe masat për ZhPM në komunën e Skenderajt janë në harmoni edhe me masat e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë, përkatësisht me objektivin 4: Zhvillimi i mësimdhënësve.

Objektivi Strategjik 2: Zbatimi i kurrikulës së re - Me kurrikulën e re, roli i shkollës është sigurimi i një mjedisi mundësues për zhvillim të kompetencave. Përbushja e këtij roli të veçantë, përveç trajnimit të mësimeve, lidhet edhe me ngritjen e kapaciteteve në udhëheqje të procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, organizimin e punës së departamenteve/aktiveve profesionale në shkollë, sigurimin e mjeteve e materialeve mësimore, si dhe përkrahjen nga DKA. Këto aspekte janë në fokus të këtij objekti.

Objektivi Strategjik 3: TIK-u dhe mjetet e konkretizimit - Përdorimi i TIK-ut ndërlidhet me pajisjen e shkollave me kompjuterë, qasja në internet, shfrytëzimin e burimeve online, sigurimin e mbështetjes teknike dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe përgatitjen e mësimeve për shfrytëzimin e TIK. Këto aspekte adresohen në masat e vendosura për arritjen e këtij objekti strategjik. Objektivi ndërlidhet me objektivin për zbatim të kurrikulës së re, Planin Strategjik për Arsim 2022-2026 dhe me prioritetet e komunës së Skenderaj për të siguruar përdorim të TIK-ut në procesin e mësimit dhe të nxënës.

Objektivi Strategjik 4: Sigurimi i cilësisë - Sigurimi i cilësisë në shkollë lidhet me vendosjen e mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë, funksionimin e departamenteve/aktiveve profesionale, koordinimin e aktiviteteve që lidhen me cilësinë, mbështetjen nga komuna, vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe planifikimin zhvillimor, monitorimin e mësimeve dhe vlerësimin e performancës së tyre. Objektivi dhe masat për sigurimin e cilësisë së arsimit në shkollat e komunës së Skenderajt janë në harmoni edhe me masat e PSAK-ut 2022-2026.

Objektivi Strategjik 5: Infrastruktura fizike - Hapësirat e mjaftueshme shkollore dhe funksionale, bëjnë që nxënësit dhe personeli arsimor të ndërveprojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Për të arritur këtë, komuna e Skenderajt është përcaktuar në arritjen e këtij objekti duke vendosur masa dhe aktivitete, që në fokus kanë përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha shkollat e komunës, sigurinë në shkolla, menaxhimin dhe mirëmbajtjen adekuate të hapësirave e objekteve shkollore si dhe hapja edhe e dy institucioneve të reja parashkollore në Skënderaj, të cilat do t'i përmbushin kërkesat e prindërve në komunën tonë.

Objektivi Strategjik 6: Arsimi dhe aftësimi profesional – Ndërlidhja e arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës kërkon kohë dhe nuk mund të arrihet pa bashkëpunim me institucionet e AAP dhe bizneset. Masat për zhvillimin e AAP në Skënderaj janë në harmoni edhe me masat e PSAK-ut 2022-2026, përkatësisht me objektivin strategjik 6: Arsimi dhe Aftësimi profesional dhe arsimit të rriturve.

Objektivi Strategjik 7: Ofrimi i shërbimeve të orientimit në karrierë.

Zhvillimi i politikave të reja komunale për orientimin në karrierë për nxënësit e klasave orientuese (6-9, X-XII), për ofrimin e shërbimeve profesionale përmes qendrave të orientimit në karrierë dhe këshilltarëve të karrierës.

Fokusi i kësaj strategjie është promovimi i orientimit në karrierë për nxënësit e shkollave tona, për aktivitete të ndryshme vetëdijesuese, për sesione informuese, vizita profesionale, punëtori etj.

Objektivi Strategjik 8: Mbështetje financiare për nxënës dhe studentë

Si pjesë e përpjekjeve për fuqizimin e arsimit profesional dhe studimeve post-diplomike komuna e Skenderaj planifikon që të ndajë bursa për nxënësit e shkollës profesionale dhe për studentët e profileve deficitare.

Orientimi i përgjithshëm

Drejtoria e Arsimit synon që procesi arsimor në Komunën e Skenderajt të zhvillohet në një ambient sa më të sigurt, modern dhe miqësor, me personel të kualifikuar dhe të aftësuar në vazhdimësi, me përgjegjësi në punë dhe me një përfshirje cilësore të të gjitha palëve të interesit. DKA synon të ofrojë arsimim gjithëpërfshirës për përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme të nxënësve dhe pavarësinë e individit në shoqëri, që të përballët me sukses ndaj ndryshimeve të shpejta, e të gjithmbarshme, në mjedisin ku jetojmë.

Drejtoria e Arsimit do të angazhohet për të siguruar arsimim sa më cilësor, i cili do të jetë i

pranueshëm për të gjitha grupmoshat e nxënësve, në mënyrë që të kenë mundësi që ta shfrytëzojnë tërë potencialin e tyre.

Mësimdhënësit, po ashtu do të kenë mundësi të vazhdueshme për zhvillim (ngritje) profesionale duke zbatuar teknikat, metodat dhe strategjitë më bashkëkohore të punës në këtë sferë. Cilësia në arsimim është pikësnyimi që ndror, duke synuar që:

- ✓ Çdo nxënës pa asnjë dallim t'i sigurohen kushtet e nevojshme për nxënie cilësore;
- ✓ Secilit nxënës t'i ofrohet mundësia e shkollimit dhe arsimimit në mjedisin më të afërt, duke ju përshtatur nevojave të tyre sociale, fizike, kulturore dhe emocionale;
- ✓ Shkollat të ofrojnë mjedise të shëndetshme, tërheqëse dhe miqësore, mësimdhënie më cilësore, mjedise më të sigurta dhe më funksionale në misionin që kanë;
- ✓ Nxënësit të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme dhe shprehitë e punës për t'iu përgjigjur me sukses sfidave të jetës së përditshme, shkollimit të mëtejshëm në përvetësimin e përhershëm të mësimin me moton "Mësimi gjatë gjithë jetës";
- ✓ Shkollat të jenë të hapura, ku prindërit do të kenë mundësi të kyçjes në vendimet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët e tyre;
- ✓ Mësimdhënësit të aftësohen në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e metodave të ndryshme bashkëkohore në procesin e mësimdhënies për zbatimin e kurrikulës.
- ✓ Zhvillimi i profileve profesionale për shkollat e mesme të larta.

Rezultatet e pritshme

Për periudhen njëvjeçare, Drejtoria e Arsimit, synon arritjen e rezultateve, si:

1. Arritja e rezultateve në shkollimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, në përputhje me planifikimet e MASHTI;
2. Inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e organizimit të mësimin;

3. Realizimi i vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, në të gjitha shkollat;
4. Organizimi i trajnimeve për dixhitalizim të shkollave dhe përdorim të tabelave interaktive, gjithëpërfshirjen, kurrikula e Re e Kosovës,
5. Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit të koordinatorëve të cilësisë, trajnimi i të gjithë koordinatorëve;
6. Hartimi i Planit Komunal për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes së shkollës. Funkcionalizimi i ekipit komunal për EPRBM. Koordinimi i EPRBM shkollorë me EPRBM komunale për rikthimi e të gjitha rasteve të braktisjes së shkollës;
7. Informimi i nevojshëm i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo - arsimor në tërësi, në komunën tonë.
8. Hartimi i Strategjisë për arsim për vitet 2024-2028
9. Hartimi i Rregullores për subvencione

Monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i monitorimit është që të shtohet cilësia në mësimdhënie dhe të nxënë, si dhe të shtohet efikasiteti i punës së institucioneve edukativo-arsimore në komunën e Skenderaj.

Gjatë vitit 2025 planifikojmë të realizojmë vizita monitoruese në të gjitha institucionet shkollorë, të jemi në kontakt të vazhdueshëm me udhëheqësinë e shkollës, mësimdhënësit, nxënësit, shërbimin teknik dhe prindërit me qëllim të ofrimit të ndihmës për ngritje të efikasitetit dhe cilësisë së punës edukativo - arsimore dhe rritjes së të gjitha potencialeve për përparim të vazhdueshëm.

Nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme, anketimeve, pyetësorëve, bashkëbisedimeve dhe shumë instrumenteve tjera, do të realizohet mbikëqyrja për së afërmi e rrjedhës së punës në shkolla. Në këtë drejtim, për ta përmbushur këtë qëllim, ne do të bashkëpunojmë edhe me Sektorin e Inspeksionit të Arsimit (SIA).

Drejtoria duke u bazuar në strukturën e organizimit dhe funksionimit të DKA-ve, në bazë të Udhëzimeve Administrative të MASHTI-it, punën e vet kryesisht do ta orientojë në:

- ✓ Në krijimin dhe mbikëqyrjen e kushteve për punë të institucioneve edukativo- arsimore në tri nivelet: 0, 1, 2 dhe 3;
- ✓ Mbikëqyrjen e realizimit të plan-programeve mësimore në institucionet edukativo- arsimore në të tri nivelet;
- ✓ Mbikëqyrjen dhe realizimin e planeve të veprimit të shkollave;
- ✓ Përcjelljen dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organeve udhëheqëse dhe profesionale të shkollave;
- ✓ Vlerësimi dhe mbështetja permanente e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nga Ekipi Vlerësues;
- ✓ Mbështetjen dhe krijimin e kushteve për punë shtesë të nxënësve me talent të veçantë dhe avancimin e tyre;
- ✓ Krijimin e kushteve të punës për stafin profesional të DKA-së, duke bërë aftësimin profesional të tyre përkrah zhvillimit të shoqërisë sonë dhe trendeve më bashkëkohore;
- ✓ Zyrtarët Komunalë Arsimorë vazhdimisht do të mentorojnë dhe monitorojnë punën në shkolla, do të hartojnë edhe raporte për funksionimin e institucioneve arsimore, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe shtimin e përgjegjësisë së të gjithëve në punë;
- ✓ Do të ofrohet mbështetje e vazhdueshme për Ekipet për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit, Koordinatorët e cilësisë, Aktivët profesionale, Këshilltarët e Karrierës etj.


Të dhënat e përgjithshme

Vitin e ri shkollor 2024/25 e kanë filluar 8031 nxënës; të grupuar në 474 paralele. Këta nxënës i vijnë në mesimet në institucionet arsimore të mëposhtme:

- 1 Institucion Parashkollor (2 IP në proces të hapjes);
- 23 Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta;
- 7 Paralele të ndara të Shkollave Filllore;
- 3 Shkolla të Mesme të Larta;
- 1 Klasë të bashkangjitur për fëmijë me nevoja të veçanta;

Numri i nxënësve sipas niveleve shkollore

Sipas të dhënave zyrtare të regjistruara në SMIA, numri i nxënësve në institucionet parashkollore është 139 nxënës, në nivelin parafillor 580 nxënës, në nivelin fillor 2994 nxënës, në nivelin e mesëm të ulët 2501 nxënës dhe në nivelin e mesëm të lartë 1909 nxënës



Të dhënat e tjera, sipas klasave për nivele shkollore, mund t'i shihni në tabelarin e mëposhtëm:

Klasa/Niveli	Mashkull	Femër	Gjithsej
Grupa 1-2	9	5	14
Grupa 2-3	12	7	19
Grupa 3-4	19	10	29
Grupa 4-5	19	11	90
Grupa 5-6 – Parashkollor (Çerdhe)	22	25	47
Gjithsej Parashkollorë (0-5 vjeç)	81	58	139
Gjithsej Parafillorë (Klasa përgatitore)	305	275	580
Klasa 1	278	285	563
Klasa 2	279	270	549
Klasa 3	315	309	624
Klasa 4	310	282	592
Klasa 5	341	325	666
Gjithsej Arsimit Fillor (Klasa 1-5)	1523	1471	2994
Klasa 6	323	279	602
Klasa 7	307	323	630
Klasa 8	323	310	633
Klasa 9	320	316	636
Gjithsej Arsimit Mesëm i Ulët (Klasa 6-9)	1273	1228	2501
Klasa 10	373	272	645
Klasa 11	334	296	630
Klasa 12	337	297	634
Gjithsej Arsimit Mesëm i Lartë (Klasa 10-12)	1044	865	1909
Gjithsej nxënës në të gjitha nivelet shkollore	4167	3864	8031

Pasqyra e numrit të paraleleve sipas klasave

Grupet/Klasat																			
Nr.	1	1	1	2	31	2	41	41	41	41	41	38	38	38	40	24	25	28	474
Grupa 0-2																			
Grupa 2-3																			
Grupa 3-4																			
Grupa 4-5																			
Grupa 5-6 - Parafillor																			
Parashkollor(Çerdhe)																			
Klasa 1																			
Klasa 2																			
Klasa 3																			
Klasa 4																			
Klasa 5																			
Klasa 6																			
Klasa 7																			
Klasa 8																			
Klasa 9																			
Klasa 10																			
Klasa 11																			
Klasa 12																			
Gjithsej paralele																			

Pasqyra e numrit të nxënësve sipas institucioneve edukativo-arsimore publike

Nr.	Institucionet edukativo-arsimore	Numri i nxënësve
1	IP "Nëna Zahide" - Skenderaj	139
2	Shfmu "Ismet Uka" - Ticë	91
3	Shfmu "Abedin Rexha" - Turicec	431
4	Shfmu "Abedin Rexha" - Burojë	68
5	Shfmu "Abedin Rexha" - Kopiliq i Poshtëm	36
6	Shfmu "Faik Dragaj" - paralele e ndarë - Leqinë	26
7	Shfmu "Faik Dragaj" - amë - Leqinë	82
8	Shfmu "Azem Bejta" - Prekaz i Epërm	305
9	Shfmu "Ilir Lushtaku" Prekaz i Poshtëm	57
10	Shfmu "Dëshmorët e Qyqavicës" - Qirez	205
11	Shfmu "Drenica" - Polac	308
12	Shfmu "Drenica" - Marinë	82
13	Shfmu "Elena Gjika" - Makerrmal	162
14	Shfmu "Enver Haliti" - Lubovec	117
15	Shfmu "Fehmi Rama" - Likoc	174
16	Shfmu "Halit Geci" - Llaushë	172
17	Shfmu "Halit Geci" - Rakinice	98
18	Shfmu "Idriz Barani" - Klinë e Epërme	309
19	Shfmu "Idriz Barani" - Ternac	24
20	Shfmu "Kuvendi i Drenicës" - Abri e Poshtme	104
21	Shfmu "Ismet Rrahmani" - Aqarevë	74
22	Shfmu "Malush Ahmeti" Rezallë	178
23	Shfmu "Migjeni" - Kllodernicë	105
24	Shfmu "Skënder Skënderi" - Vajnikë	98
25	Shfmu "Shaban Jashari" - Skenderaj	1335
26	Shfmu "Shotë Galica" - Runik	338
27	Shfmu "Shotë Galica" - Syrganë	11
28	Shfmu "Vëllezërit Frashëri" - Qubrel	123
29	Shfmu "Ahmet Delia" - Skenderaj	746
30	Shfmu "Bashkim Sadiku" - Tushilë	37
31	Shfmu "Pavarësia" - Krasaliq	82
32	Gjimnazi Hamëz Jashari - Skenderaj	522
33	SHMLP Anton Çetta - Skenderaj	659
34	SHMLP Anton Çetta - Runik	17
35	Qendra e Kompetencës - Skenderaj	681

Aktivitete e DKA-së në Skenderaj për vitin 2025

Aktivitete	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përgatitja dhe shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve të klasave të para-arsimi fillor				✓	✓								DKA Shkollat
Java e gjelbërimit për shkollat e komunës				✓									DKA Komuna
Vazhdimi i bashkëpunimit me drejtori komunale dhe shkolla të shteteve të ndryshme si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe arsimin e Skenderaj	✓	✓	✓	✓	✓	✓			✓	✓	✓	✓	DKA Shkollat
Përgatitja për kremtimin e "17 Shkurtit" – Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës	✓	✓											DKA Shkollat
Epopeja e UÇK-së, 5,6 dhe 7 mars		✓	✓										DKA Shkollat
Takim përmbyllës me nxënës të daluar, mësime dhe drejtorë. Përgatitja e mirënjohjeve dhe shpërblimeve modeste						✓							DKA Shkollat
Organizimi i garave në nivel komune me nxënës të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në lëndë shkencore			✓	✓	✓								DKA Shkollat
Realizimi i trajnimit për zbatimin e KK-së						✓		✓					DKA Shkollat
Bashkëpunimi me MASHTI-in	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA MASHTIT, SIA
Përgatitja për kremtimin e ditës së fëmijëve "1 Qershor"					✓	✓							DKA Çerdhet
Përgatitja e projekteve për rregullim të infrastrukturës shkollë, oborreve dhe këndeve të gjelbëruara të shkollave							✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA
Kompletimi dhe dërgim i të dhënave në MASHTI, me qëllim publikimi të konkursit për regjistrim të nxënësve në SHML (Shkollat e Mesme të Larta)					✓	✓							DKA MASHTIT
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme të larta						✓	✓	✓	✓				DKA

Grumbullimi i kërkesave prej shkollave për konkursin e rregullt për personel arsimor të kualifikuar				√									Shkollat DKA
Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës me mësimdhënës të kualifikuar					√								DKA
Grumbullimi i kërkesave prej shkollave për konkursin plotësues për personel arsimor të kualifikuar									√				Shkollat DKA
Shpallja e konkursit të plotësues për plotësimin e vendeve të lira të punës me mësimdhënës të kualifikuar										√			DKA
Realizimi i trajnimeve për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës		√	√	√	√	√							DKA Partnerët
Realizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të EPRBM-ve			√	√	√								DKA Partnerët
Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në Shkollat e Mesme të Larta								√					DKA Shkollat
Takime me kryesitë rinore të shkollave dhe me përfaqësues të prindërve			√			√							DKA Shkollat
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme nga konkursi plotësues								√					DKA
Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditarë pune, libra amë, libra të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor						√	√	√					DKA
Analiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit shkollor 2022/2023, nëfund të dy gjysmëvjetorëve dhe në fundin e vitit mësimor	√					√			√				DKA
Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit të ri shkollor		√	√			√	√	√	√				DKA Kuvendi Komunal
Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturantëve									√				DKA
Realizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Ekipeve Vlerësuese				√	√	√							DKA Partnerët
Takimi i rregullt me drejtorë shkollash	√	√	√	√	√	√		√	√	√	√	√	DKA Drejtorët e shkollave

Aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përgatitja teknike e objekteve shkollore: gëlqerosja, riparimi infrastrukturor, riparimi i inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri							✓	✓			✓		DKA
Realizimi i procedurave për përzgjedhjen e operatorit furnizues me lëndë djegëse						✓							DKA
Përzgjedhja e operatorit për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse në koordinim me Zyrën e Prokurimit							✓						DKA
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse							✓						DKA
Kontrollimi i sistemit të ngrohjeve nëpër shkolla							✓						DKA
Përcjellja e punëve në ndërhyrjet infrastrukturorë në shkolla							✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA MASHTI
Riparimi i nyjeve të ujësjesve dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë probleme me ujë të pijshëm							✓	✓	✓				DKA
Furnizimi i shkollave me mjete mësimore didaktike e kabinetike për lëndët: TIK, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, etj.							✓	✓	✓	✓			DKA Donatorët
Furnizimi i shkollave me inventarë shkollore: banka, karrige, tavolina, tabela dhe dollapë për bibliotekat shkollore							✓	✓					DKA
Rregullimi i shkollave dhe oborreve shkollore				✓	✓	✓	✓	✓					DKA
Rregullimi i terreneve sportive				✓	✓	✓	✓	✓					DKA
Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste							✓	✓					MASHTI DKA
Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit	I përhershëm, sipas nevojës												DKA
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave												DKA
Furnizimi i shkollave me karburant për gjeneratorët	Sipas kërkesave												DKA
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave	Sipas kërkesave												DKA

Aktivitete që kanë të bëjnë me procesin edukativo - arsimor

Aktivitete	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Organizimi i mësimit shtesë për maturanët				✓	✓								Shkollat
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbëruara shkollore				✓	✓	✓	✓	✓	✓				DKA
Organizimi i trajnimeve për mësuesin në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas Prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësuesve të Komunitetit të Skenderajt	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA MASHTIT Donatorët
Përcjellja e braktisjes së nxënësve-detyrë permanente	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA
Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkollë, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, etj.				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA
Analiza e punës edukativo-arsimore					✓		✓					✓	DKA
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I përhershëm, sipas nevojës												DKA
Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas kërkesave të shkollave	Sipas nevojës duke i respektuar afatet dhe procedurat												DKA
Plotësimi i vendeve të lira të punës	Sipas nevojës duke i respektuar afatet dhe procedurat												DKA
Vlerësimi i punës edukativo-arsimore të shkollave nëpërmjet të vizitave dhe bashkëpunimit me prindër				✓	✓	✓			✓	✓	✓	✓	DKA Shkollat
Përgatitja profesionale e arsimtarëve, organizimi i trajnimeve sipas PZHPM-së					✓	✓				✓	✓	✓	DKA Donatorët
Përgatitjet për kremtimin e festave shtetërore	✓	✓						✓	✓	✓	✓	✓	DKA
Organizimi i vizitave studimore me stafin e DKA-së jashtë vendit	Sipas kërkesave, ftesave												DKA
Përcjellja permanente e aktiviteteve mësimore e jashtëmësimore të nxënësve nëpër shkollë	E vazhdueshme												DKA

Organizimi dhe mbajtja e garave me titull : "Gjuhëtari i ri " në shkallë komunale dhe në shkallë vendi					✓	✓							DKA KK SHGJSHK
Organizimi dhe mbajtja e garave të shkollave të recituesve si dhe festivali i dramës					✓								DKA DKRS
Përcjellja e realizimit të mbrëmjeve të maturës					✓	✓							DKA
Mbarimi i mësimit për maturantët	15 maj 2025												Shkollat
Mbarimi i mësimit për semimaturantë dhe shkolla të mesme të larta	05 qershor 2025												Shkollat
Mbarimi i mësimit për parafillorët dhe klasat 1-8	23 qershor 2025												Shkollat
Riprovimet për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lëndë mësimore	20 - 21 maj 2025												Shkollat
Publikimi i rezultateve të provimit shtetëror të maturaes	14-20 qershor 2025												MASHT IT DKA
Shqyrtimi i ankesave eventuale të parashtruara nga nxënësit	15 - 25 qershor 2025												MASHT IT DKA
Publikimi i rezultateve të shqyrtimit të ankesave	22-26 qershor 2025												MASHT IT DKA

Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-së me Kryetarin e Komunës, MASHTI-in, Drejtoritë Komunale dhe me Qytetarët

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Takimet dhe konsultimet me kryetarin e Komunës	Të përhershme, sipas nevojës												DKA
Takimet e rregullta me ministrin e arsimit, në kuadër të takimeve me drejtorët e DKA-ve	Të përhershme, varësisht nga ftesat												DKA MASHTI
Furnizimi me ligjet e reja, udhëzimet, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASHTI-i	Sipas nevojës												DKA MASHTI
Përcjellja e kërkesave, shkresave, raporteve dhe informatave nga aktiviteti i DKA-së në MASHTI	Sipas nevojës												DKA MASHTI
Kontaktet e rregullta me Departamentin e Arsimit Parauniversitar,Infrastrukturës, Njësinë për Vlerësime dhe zyrtarë të ndryshëm arsimorë	Sipas nevojës												DKA MASHTI
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiut të Drejtorëve të DKA-ve të Kosovës	Të përhershme, varësisht nga ftesat												DKA

Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore, të mesme dhe institucionit parashkollor	✓		✓		✓	✓	✓		✓	✓	✓	✓	DKA
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre				✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	DKA
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS	I përhershëm, sipas nevojës												DKA
Bashkëpunimi i rregullt me Sektorin e Inspektionit të Arsimit	Sipas nevojës												DKA
Puna me palë, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	E përditshme dhe sipas kërkesave												DKA

Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat dhe komunitetin

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore e shoqërore organizuar nga OJQ-të	Sipas organizimit dhe ftesës												DKA
Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	Sipas nevojës												DKA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	Sipas kërkesave												DKA
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	Sipas kërkesave												DKA
Bashkëpunimi me donatorë vendorë e të huaj	Sipas nevojës												DKA

**Bashkëpunimi me përfaqësuesin e komunës për implementimin
e projekteve që kanë të bëjnë me *Integrimet Evropiane***

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përmirësimi i infrastrukturës, sigurimi i transportit dhe rritja e sigurisë në shkolla	Në vazhdimësi												DKA DSHPI
Hartimi i programeve, plan-programeve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimitdhënësve duke u mbështetur në PZHPM	Në vazhdimësi												DKA
Përmirësimi i infrastrukturës ligjore për të favorizuar pjesëmarrje dhe punësim më të barabartë në pozitë udhëheqëse në institucionet arsimore	Në vazhdimësi												DKA
Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës prioritare	Në vazhdimësi												DKA DSHPI
Përgatitjet dhe kompletimi i dokumentacioneve për projekte (paramasat dhe paralogaritë) e ndërtimeve të objekteve shkollore	Në vazhdimësi												DKA DSHPI
Zgjerimi i hapësirave-lokaleve ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punëve gjatë renovimeve	Në vazhdimësi												DKA DSHPI
Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje, si dhe përcaktimi i prioriteteve të shkollave me nevoja më të theksuara	Në vazhdimësi												DKA DSHPI
Implementimi i Strategjisë për Arsimimin e Komuniteteve	Në vazhdimësi												DKA DSHPI
Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve në arsimin parashkollor	Në vazhdimësi												DKA DSHPI

Plani i Rekrutimit të Personelit Arsimit

Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara rekrutimet sipas niveleve shkollore dhe llojeve të personelit të paraqitura për vitin 2025. Përveç pensionimeve janë të paraqitura edhe kërkesat e reja, që janë si rezultat i zbatimeve të politikave të reja arsimore në nivel vendi. Duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publikë dhe klasifikimin e ri të personelit arsimor, ku kanë ndryshuar disa procedura të inicimit dhe rekrutimit të personelit arsimor, duhet që shumë herët të zhvillohen procedurat e rekrutimit edhe për pozitat e lira, që janë si rezultat i pensionimeve edhe pozitat e reja. Po ashtu, një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet edhe rekrutimit të personelit për zëvendësimet, me theks të veçantë zëvendësimet e pushimeve të lehonisë. Duhet të kërkohet nga shkollat që sa më herët që mundën të na i sjellin kërkesat për zëvendësime, në mënyrë që të kemi kohë t'i zhvillojmë procedurat për rekrutim.

Draft-planin për rekrutimin e personelit arsimor e kemi përgatitur dhe e pasqyrojmë në formën e mëposhtme tabelare.

DRAFT- PLANI I REKRUTIMIT TË PERSONELIT ARSIMOR 2025

Niveli arsimor	Gjithsej numri i rekrutimeve	Pozitat që duhet të plotësohen	Pozitat e reja
Institucione Parashkollore (Çerdhe)	11	Edukatore, motër edukatore, edukatore për parashkollore	11 në proces
Shkollë Fillore e Mesme e Ulët (ShFMU)	12	4 Mësimdhënës klasorë 6 Mësimdhënës lëndorë 2 Punëtorë teknikë	3 Psikologë 7 Asistentë për Fëmijë me Nevoja të Veçanta arsimore
Shkollë e Mesme e Lartë (ShML)			
Totali	33	12	21

Buxheti i Arsimit për vitin 2025 sipas kategorive

Në tabelarin e paraqitur në vijim është i pasqyruar buxheti sipas kategorive (Granti Specifik i Arsimit, Të hyrat vetanake) dhe niveleve shkollore (Arsimi Parashkollor, Arsimi Fillor dhe Arsimi i Mesëm i Lartë). Buxheti në total për vitin 2025 është 7,932,530.00 €.

Buxheti i Kosovës për vitin 2025 - Komunitat

Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2025

Shall	Kodi	Kodi	Kodi	Komuna	Programi	Nonprogrami	Pershkrimi	Shall	Plani dhe Modifi	Ministrit dhe Shpenzimet	Shpenzimet komunele	Subvenzionet dhe Transferet	Shpenzimet Kapitale	Rezerua	Total 2025	Total 2025	Total 2027
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n	o	p	q	r
020					Arsimi dhe Shkencat		Total Shpenzimet Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake Financim i Jashtem Financim nga Burimet e Proprieta	974	7,040,238	573,474	59,300	30,000	150,678		1,327,530	4,420,437	5,551,565
							Grantet Qeveritare	974	7,040,238	403,472	59,300	30,000	90,678		1,225,454	5,161,317	6,092,105
							Të Hyrat Vetanake			110,000			60,000		266,000	278,390	272,790
							Financim i Jashtem										
							Financim nga Burimet e Proprieta										
52115	0300				Administrata		Total Shpenzimet Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake Financim i Jashtem Financim nga Burimet e Proprieta	10	71,710	21,550		30,000			180,260	194,130	198,260
							Grantet Qeveritare	10	71,710	21,550		30,000			180,260	194,130	198,260
							Të Hyrat Vetanake										
							Financim i Jashtem										
							Financim nga Burimet e Proprieta										
04510	0511				Arsimi Parashkollor		Total Shpenzimet Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake Financim i Jashtem Financim nga Burimet e Proprieta	49	400,000	75,100	5,700				480,800	498,600	510,200
							Grantet Qeveritare	49	400,000	75,100	5,700				480,800	498,600	510,200
							Të Hyrat Vetanake			60,000					60,000	70,700	70,700
							Financim i Jashtem										
							Financim nga Burimet e Proprieta										
03040	0512				Arsimi Fillor, i Mesëm i Ulët		Total Shpenzimet Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake Financim i Jashtem Financim nga Burimet e Proprieta	635	5,281,526	415,324	41,800		150,944		5,987,244	6,364,258	6,846,506
							Grantet Qeveritare	635	5,281,526	403,324	41,800		90,344		5,842,344	6,164,258	6,552,500
							Të Hyrat Vetanake			10,000			60,600		146,000	200,000	198,000
							Financim i Jashtem										
							Financim nga Burimet e Proprieta										
03040	0522				Arsimi i Mesëm i Lartë		Total Shpenzimet Grantet Qeveritare Të Hyrat Vetanake Financim i Jashtem Financim nga Burimet e Proprieta	150	1,202,626	64,300	11,800				1,278,726	1,283,125	1,380,825
							Grantet Qeveritare	150	1,202,626	64,300	11,800				1,278,726	1,283,125	1,380,825
							Të Hyrat Vetanake										
							Financim i Jashtem										
							Financim nga Burimet e Proprieta										
Total shpenzimet për Komune																	
Total Shpenzimet								0	0	0	0	0	0		0	0	0
Grantet Qeveritare								0	0	0	0	0	0		0	0	0
Të Hyrat Vetanake								0	0	0	0	0	0		0	0	0
Financim i Jashtem								0	0	0	0	0	0		0	0	0
Financim nga Burimet e Proprieta								0	0	0	0	0	0		0	0	0


Programi i Investimeve Kapitale për vitin 2025

ARSIMI						
	Projektet		2025	2026	2027	Pershkrimi
2	Furnizimi me pajisje, kabinete dhe laboratore shkollore	Vazhdim	99,000.00	56,859.85	43,289.44	Shkollat do të pajisen me kabinete dhe laboratore shkollore
3	Furnizimi me tabela interaktive - digjitale	Vazhdim	28,614.00	55,000.00		Digjitalizimi i shkollave do të bëhet me tabela interaktive, projektorë dhe PC në klasa.
5	Ndërtimi i këndeve për lojëra në shkolla	I ri	22,904.00	150,000.00	240,710.56	Në oborret e disa shkollave do të bëhet ndërtimi i këndeve për lojëra të fëmijëve
Gjithsej:			152,543.00	263,885.85	240,710.56	

Punës

Skenderaj, dhjetor 2024

Drejtori i DKA-së
Kastriot Duraku



Plani i 2025